

UDHËZIM
Nr.1240/4,datë 15.9.2009

**PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR.13, DATË 12.2.2009 “PËR
PËRCAKTIMIN E TARIFËS SË SHËRBIMIT PËR VEPRIME E SHËRBIME TË
ADMINISTRATËS GJYQËSORE E MINISTRISË SË DREJTËSISË, PROKURORISË,
NOTERISË DHE ZYRËS SË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTHME”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës dhe të nenit 11 të ligjit nr.9975, datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare”, Ministri i Financave dhe Ministri i Drejtësisë

UDHËZOJNË:

1. Në titullin e udhëzimit pas fjalëve “Ministrisë së Drejtësisë” shtohen fjalët “Për shërbimin përmbarimor gjyqësor privat”.

2. Në pjesën hyrëse të udhëzimit, te baza ligjore shtohet edhe referimi në paragrafin e parë të nenit 47 të ligjit nr.10031, datë 11.12.2008 “Për shërbimin përmbarimor gjyqësor privat”.

3.Shtojca nr.1, tabela B, zëvendësohet me tabelën si vijon:

		Masa e tarifës në lekë	Masa e tarifës në %
B.	Tarifë për veprime që kryhen nga përmbaruesi gjyqësor shtetëror dhe privat:		
1.	Për vënien në ekzekutim të vendimeve e titujve të tjerë ekzekutivë me objekt të pavleftësueshëm	3500	
2.	Për vënien në ekzekutim të vendimeve të titujve të tjerë ekzekutivë me objekt të vleftësueshëm:		
	a) kundrejt shtetasve		2%
	b) kundrejt personave juridikë		2%
3.	Për lajmërimet dhe veprimet e tjera të përmbaruesit gjyqësor	200	
4.	Për lëshime nga përmbaruesi gjyqësor të çdo lloj akti ose dokumenti të kërkuar nga të interesuarit	200	
5.	Për vënien në ekzekutim të vendimeve me objekt pension ushqimor	0	

4. Tarifat e përcaktuara sipas pikës 3 për shërbimin përmbarimor gjyqësor shtetëror zbatohen mbas hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi.

5. Tarifat e përcaktuara sipas pikës 3 për shërbimin përmbarimor gjyqësor privat zbatohen me fillimin e aktivitetit të përmbaruesve gjyqësorë privatë.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Ministri i Drejtësisë
Enkelejd Alibeaj

Ministri i Financave
Ridvan Bode